Interreg Mediterranean
EUROPEAN UNION
ENERJ
Project co-financed by the European Regional Development Fund

Gazeta #4 | Tetor 2018

Direktiva e re e Efiçiences se Energjise – Targeti i ri 32.5% per 2030

Komisioni Evropian deshiron te zgjoje "Gjigantin e gjumit", efiçiencen e energjise . Nje e treta e emetimeve te gazeve sere vjen nga ndertesat dhe ashtu si me sektorin e transportit potencialet per reduktim mbeten shume prapa. Efiçienca e energjise ne Bashkimin Evropian pritet te rritet me 32.5% deri ne vitin 2030. Kjo u miratua nga negociatoret e Parlamentit Evropian, vendet anetare te BE-se dhe Komisioni Evropian ne qershor te ketij viti. *"Kjo marreveshje eshte nje shtytje e madhe per pavaresine energjetike te Europes. Pjesa me e madhe e asaj qe shpenzohet ne lendet djegese fosile te importuara tani do te investohen ne shtepi, ne ndertesa, industri dhe transport me efiçient. Synimi i ri i 32.5% do te rrise konkurrencen tone industriale, do te krijoje vende pune, do te zvogeloje faturat e energjise, do te ndihmoje ne perballimin e varferise energjetike dhe ne permiresimin e cilesise se ajrit ",* tha Komisioneri i BE-se per Klimen Miguel Arias Canete.
Shtetet e BE-se kerkuan nje rritje te efiçiences se energjise me 30%, Parlamenti Evropian donte 35%. Objektivat e reja te efiçiences se energjise jane projektuar per te ndihmuar ne permbushjen e qellimeve te Marreveshjes se Klimes se Parisit dhe per te parandaluar mbinxehjen e tokes. Marreveshja duhet te konfirmohet zyrtarisht ne muajt e ardhshem nga parlamenti dhe shtetet e BE-se. Sapo te hyjne ne fuqi rregullat e reja, vendet e BE-se kane nje vit e gjysem kohe per t'i transpozuar ato ne ligjin kombetar.
Me shume informacion
Energy Efficiency | Energy Union | Investment Plan for Europe: the Juncker Plan

Raporti 1.5 °C, IPCC

Raporti i posaçem i Panelit Nderqeveritar per Ndryshimet Klimatike (IPCC) me titullin lakonik "1.5 °C" tregon nje ndryshim te rendesishem ne pasojat e ndryshimeve klimatike midis nje rritjeje prej 2 °C dhe nje nga 1.5 °C ne kete shekull. Marreveshja e Parisit ka perdorur ne nenin 2 formulen "mbajtja e rritjes se temperatures mesatare globale shume me poshte se 2 °C mbi nivelet para-industriale dhe duke vazhduar perpjekjet per te kufizuar rritjen e temperatures ne 1,5 °C". Shpresa per te qene ne gjendje per te ruajtur rritjen globale te temperatures me pak se dy grade gjate ketij shekulli tashme nuk ishte shume e madhe ne komunitetin e eksperteve te klimes, madje edhe ta kufizonte ate ne 1.5 °C mbi nivelet paraindustriale, qe do te thote te zvogeloje emetimet e CO_2 me 45% deri ne 2030, duke zbritur ne zero ne mes te shekullit. Raporti kembengul se ekzistojne rruget per te kufizuar ngrohjen globale me 1.5 °C, por kerkojne nje tranzicion te shpejte dhe te gjere ne energji, toke, qytet dhe infrastrukture (perfshire transportin dhe ndertesat) dhe sistemet industriale.
Raporti prej 1,5 ° C eshte nje tjeter shenje e forte dhe e pagabueshme e rendesise se madhe te efiçiences se energjise ne ndertesa. Transformimi i energjise deri ne vitin 2050 do te kete sukses vetem nese konsumi i energjise do te pergjysmohet ne terma absolute si dhe konsumi i energjise, sidomos per ajer te kondicionuar ne ndertese, i cili eshte nje faktor kyç.
Me shume informacion
IPPC website

Planet Lokale te Veprimit te Perbashket per Efiçiencen e Energjise ne Ndertesat Publike

Ne zemer te ENERJ ekzistojne Planet e Veprimit te Perbashket per Efiçiencen e Energjise ne Ndertesat Publike. Eshte nje ide terheqese te grupojme se bashku masat e mundshme per te bere "paketen" me interesante per ESCO-t dhe institucionet financiare. Nuk eshte e re, Berlini po e ben kete "lidhje" te projekteve qe nga fillimi i viteve nentedhjete te shekullit te kaluar, por veprimet e perbashketa vazhdojne te ofrojne sfida kulturore, organizative, ligjore dhe financiare. Ne kete periudhe partneret e ENERJ jane duke perpunuar Planet e tyre Lokale te Veprimit te Perbashket qe do te sherbejne si nje instrument i vlefshem per te promovuar grumbullimin e projekteve me te vogla ne paketa te konsiderueshme dhe per te mobilizuar sasine e financave te nevojshme.

Partneri kryesor i ENERJ, Anatoliki, ka perpunar nje draft te Planit te Veprimit te Perbashket. Ne baze te auditimeve te energjise dhe analizave te kostos, ata jane ne gjendje ti propozojne tre qeverive lokale nje pakete prej 14 ndertesash qe demonstrojne kosto dhe kursime te nje renovimi te thelle.

Pjesa e dyte e Planit te Veprimit merret me çeshtjen kryesore te organizimit ligjor dhe organizativ. Anatoliki propozon disa skenare, mes tyre nje Kontrate Programimi ose krijimin e nje komuniteti energjetik. Puna eshte ne vazhdim dhe pjesa e dyte e ENERJ do te tregoje mundesite e ndryshme per Veprimet e Perbashketa dhe zbatueshmerine e tyre ne kontekste te ndryshme territoriale.

ENERJ NE EVENTE NDERKOMBETARE

Konferenca afatmesme e projektit Interreg MED PrioritEE Athine, 21 qershor 2018

ANATOLIKI, Agjencia e Zhvillimit te Autoriteteve Lokale te Selanikut Lindor, mori pjese ne 21 Qershor 2018 ne konferencen e transferimit dhe shperndarjes se rezultateve te projektit. Prezantimi i Kostas Konstantinou u perqendrua ne konceptin e Veprimit te Perbashket ne permiresimin e energjise te ndertesave publike siç eshte prezantuar me metodologjine ENERJ. Per me teper, ai shtjelloi çeshtjen lokale te veprimit te perbashket te Greqise, ku tre bashki te zones me te gjere te Selanikut jane perfshire ne percaktimin e nje plani lokal te veprimit te perbashket dhe jane analizuar perfundimisht rezultatet e arritura deri tani. Keto rezultate ishin te lidhura me rezultatet e auditimeve te energjise dhe analizes perkatese te kryer ne 14 ndertesat Bashkiake te tri Bashkive qe perbejne studimin e rastit per Greqine.

Konferenca Nderkombetare e Aleances Klimatike 2018 Barcelone, 1 - 3 tetor, 2018

ENERJ u prezantua ne seminarin "Tranzicioni energjetik ne qytete dhe rajone" nga Dr Karl-Ludwig Schibel, me rastin e Konferences Nderkombetare te Aleances per Klimen 2018. Fokusi i seances ishte ne implementimin e nje tranzicioni lokal te energjise, duke trajtuar problemet teknologjike, financiare dhe aspekte te lidhura me qeverisjen. Dr. Schibel prezantoi duke nenvizuar rendesine e efiçiences se energjise per tranzicionin energjetik dhe prezantoi projektin ENERJ si nje nga serite e projekteve Interreg Med qe perqendrohen ne efiçiencen e energjise ne ndertesat publike. Ai konkretizoi konceptin e veprimeve te perbashketa me nje aktivitet te partnerit Anatoliki qe ka punuar me tre qeveri lokale, Thermi, Pilea-Hortiatis dhe Thermaikos. Ne baze te SEAP-it te tyre, ata kryen auditime energjetike ne ndertesat publike te ketyre tre qyteteve, 14 ndertesa te gjitha se bashku, dhe llogariten fitimet e pergjithshme te konsumit, kostot perkatese, kohen mesatare te rimbursimit ne pergjithesi, si dhe dhe per çdo ndertese.

Ne diskutim Schibel nenvizoi potencialet e nje projekti evropian si ENERJ per ta bere transparente per te gjithe aktoret e perfshire mundesine e Veprimit te Perbashket dhe perparesite e tij ne aspektin ekonomik.

Konferenca e Komunitetit MED-Ndertesat Efiçiente & Energjia e Rinovueshme. Lubljane, 18 - 19 tetor, 2018

Konferenca "Ndertimi i kapacitetit tone te ndikimit per nje model efiçient, gjitheperfshires dhe te rinovueshem te energjise per zonen MED" u zhvillua ne Ljubljane me 18 dhe 19 Tetor. Koferenca priti partnere te te gjitha Projekteve Modulare Interreg MED te dy Komuniteteve: Komuniteti i Ndertesave Efiçiente dhe Komuniteti i Energjise se Rinovueshme.

Projektet jane ne mesin e afatit te performances se tyre te pergjithshme dhe konferenca prezantoi rezultatet e tyre te vazhdueshme per ekspertet dhe institucionet strategjike. Nje dialog prej dy ditesh sherbeu per te kuptuar sfidat specifike qe ndeshin politikat e efiçiences se energjise dhe burimeve te rinovueshme te energjise ne zonen MED, ne nje takim midis projekteve te dy komuniteteve te MED, perfaqesuesve te Komisionit Evropian, EIB, rrjeteve te qytetit dhe anetareve te qeverise Sllovene.

LAJME NGA PROJEKTET

Komuniteti i Ndertesave Efiçiente

Broshura dhe videoja e re e Komunitetit te Ndertesave Efiçiente - Komuniteti MED per nje ndertese publike me efiçiente te animuar nga projekti horizontal MEDNICE - jane online.
Hidhni nje sy dhe ndajeni!

Projekti FINERPOL

FINERPOL
Interreg Europe
European Union
European Regional
Development Fund

Komunikimi i Efiçiences se Energjise eshte nje pune shume e veshtire. Projekti Interreg Europe FINERPOL ka prodhuar nje video argetuese qe ben nje pune te shkelqyeshme ne kete fushe te veshtire. Shikoje per veten tende.

Projekti Trust EPC South

TRUST
EPC SOUTH

Trust EPC South ka bere publike nje broshure shume te lexueshme mbi Kontratat e Performances se Energjise, me nje pasqyre te tregjeve kombetare EPC ne Kroaci, France, Greqi, Itali, Spanje dhe Portugali dhe rezultatet e projektit te tyre H2020 mund ti gjeni ketu.

Eventet e ardhshme

22 Nentor 2018 - St-Julians (Malte) - Financimi i Efiçiences se Energjise ne Malte dhe Itali

Kjo konference synon te shperndaje praktikat me te mira nga Malta dhe Italia, si dhe nga vendet e tjera per menyren e financimit te investimeve per efiçiencen e energjise. Konferenca do te mbuloje, nder te tjera, pervojen e fituar nga perdorimi i fondeve private dhe instrumenteve inovative te financimit, veçanerisht ne sektorin e ndertesave dhe te industrise. Folesit do te perqendrohen ne njohurite praktike ne zhvillimin dhe strukturimin e programeve te investimeve. Do te kete kohe per debat dhe networking.

Ky event organizohet nga Komisioni Evropian ne partneritet me Iniciativen Financiare te Mjedisit te UN, Ministrine e Energjise dhe Menaxhimin e Ujerave te Maltes dhe Ministrine e Transportit, Infrastruktures dhe Projekteve Kapitale te Maltes. Ky event eshte pjese e Forumeve te Investimeve te Qendrueshme te Energjise, financuar nga programi Horizon 2020 i Bashkimit Evropian. Konferenca do te mbahet ne gjuhen angleze.

3 - 14 dhjetor, Katowice (Poloni) Konferenca e 24 e Paleve (COP 24)

Konferenca e ardhshme e UN-se per Ndryshimet Klimatike (COP24) eshte nje moment i rendesishem ne debatin nderkombetar. Ajo u percaktua ne Marreveshjen e Parisit si nje rast per te shqyrtuar perpjekjet kolektive drejt qellimeve afatgjata te marreveshjes 3 vjet pas miratimit te tij. Kjo do te ofroje gjithashtu rastin per te demonstruar se si autoritetet rajonale dhe lokale mund te kontribuojne ne perpjekjet globale, duke ndihmuar ne rritjen e ambicies kombetare.

4 - 5 dhjetor 2018 - Gavião (Portugali) - Takimi i 5-te i Projektit ENERJ

AREANATejo dhe CIMAA do te prese takimin e 5-te te Projektit dhe takimin e Komitetit Drejtues / Transnacional ne Portugali. Partneret do te diskutojne kryesisht per progresin qe eshte arritur ne percaktimin e Planit Lokal te Veprimit te Perbashket dhe zbatimin e aktiviteteve ne fazen e ardhshme te projektit.

11 dhjetor 2018 - Katowice (Poloni) - Dita e Energjise e BE ne COP24

Dita e 6-te e Energjise se BE do te zhvillohet ne Katowice, si pjese e programit te eventeve te BE ne Konferencen e Kombeve te Bashkuara per Ndryshimet Klimatike COP24.

Ajo do te tregoje disa nga nismat e nisura per te mbeshtetur nje tranzicion te paster te energjise ne BE dhe me gjere dhe te reklamoje progresin e bere tashme ne drejtim te permbushjes se angazhimeve te BE-se, duke perfshire objektivat e vitit 2030 dhe Paketen e Energjise se Paster.

Me shume informacion

Per mediat sociale ndiqni: #EUEnergyDay dhe @ Energy4europe

Project co-financed by the European Regional Development Fund

Joint Actions for Energy Efficiency

Shkarko Broshuren e Projektit ENERJ

Partneret

Anatoliki S.A.-Development Agency of Eastern Thessaloniki's Local Authorities (EL)	FAMP-Andalusian Federation of Municipalities and Provinces (ES)	IRENA-Istrian Regional Energy Agency L.t.d. (HR)

CEA-Cyprus Energy Agency (CY)	Gozo Development Agency – Gozo Regional Committee (MT)	Metropolitan City of Capital Rome (IT)	GOLEA-Goriška Local Energy Agency (SI)
MIE – Ministry of Infrastructure and Energy (AL)	AREANATejo-Regional Energy and Environment Agency from North Alentejo (PT)	Climate Alliance Italy (IT)	CIMAA-Intermunicipal Community of High Alentejo (PT)

ENERJ mbeshtetet nga Fondi Europian Rajonal i Zhvillimit (ERDF) ne kuader te Programit Interreg MED.

ENERJ (Veprimet e Perbashketa per Efiçiencen e Energjise) mbeshtet qytetet ne zbatimin e veprimeve te efiçiences se energjise ne ndertesat e tyre si pjese e politikes se tyre lokale te energjise dhe klimes. Ajo nxit bashkepunimin midis qeverive lokale per Veprime te Perbashketa. Nje platforme ENERJ lehteson hartimin e Veprimeve te Perbashketa dhe ka nje database per Planet Lokale te Veprimit te Energjise dhe masat per Eficiencen e Energjise.

Projekti ENERJ po zhvillohet nga Nentori 2016 deri ne Prill 2019 me nje buxhet total prej 2.26 milione eurosh. Fondet e BE-se 1.92 milion Euro.

Partneri kryesor : ANATOLIKI S.A. - Agjencia e Zhvillimit te Autoriteteve Lokale te Selanikut Lindor
email: reacm@anatoliki.gr / tel. +30 231 0463930